

Në 9 nëntor 2025 votohet për të zgjedhur kryetarët e bashkive
Berat, Tepelenë, Cërrik, Mat dhe Vlorë

HAPAT PËR TË VOTUAR

Nëse je zgjedhës në bashkitë **Tiranë, Berat, Tepelenë, Cërrik, Mat dhe Vlorë,**




Paraqitu në Qendrën e Votimit me **dokumentin e identitetit, pasaportë ose letërnjoftim.**




Trego dokumentin e identitetit përpara **Komisionit të Qendrës së Votimit.**




Identifikohu përmes pajisjes së identifikimit elektronik me dokumentin e identitetit dhe më pas **nënshkruaj duke lënë shenjën e gishtit.**




Merr **fletën e votimit** dhe sigurohu që të jetë e **vulosur me dy vula**, në faqen që nuk janë të shënuara emrat e kandidatëve.




Shko i vetëm në dhomën e fshehtësisë bashkë me fletën e votimit.



Shëno me shenjën **X** ose **+** brenda kutisë përbri preferencës tënde, në fletën e votimit.



Palos fletën e votimit në dhomën e fshehtësisë, në mënyrë që zgjedhja juaj të mos identifikohet dhe **të paktën një nga vulat** të jetë e dukshme.



Më pas hidh fletën në **kutinë e votimit** dhe largohu nga Qendra e Votimit.

